

**DREJTUAR: AKM-TIRANE**  
**PER DIJENI: DRM-VLORE**  
**BASHKISE HIMARE**

**LENDË: KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:**

**ID 3.1, e. "PERZIERJA E ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS NË MASË TË MADHE POR JO NË SHESHIN E NDËRTIMIT, PËRFSHIRË AMBALAZHIMIN DHE PËRZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE PRODHIMI I BLOQEVE TË BETONIT DHE PRODUKTEVE TË TJERA TE ÇIMENTOS (IMPIANT PER PRODHIM BETONI)"**

**SUBJEKTI : SUBJEKTI "GJIKURIA" SH.P.K.**

**ADMINISTRATORI: Z. FLORENC GJIKURIA**

**ADRESA : VLORE, HIMARE, KOMPLEKSI GREEN  
COAST, PALASE, QARKU VLORE.**

**VLORE 2017**

Subjekti "GJIKURIA" Sh.p.k. me perfaqesues ligjor Z.FLORENC GJIKURIA merret me aktivitetin ID 3.1, e. Perzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos (Prodhimin dhe tregjetimin e betonit me shumice dhe pakice)

Subjekti "GJIKURIA" Sh.p.k. me perfaqesues ligjor Z.FLORENC GJIKURIA ne Perputhje me VKM nr. 419 date 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja , ky subjekt duhet te aplikojë per leje mjedisi të tipit B.

SUBJEKTI : SUBJEKTI "GJIKURIA" SH.P.K. ME NR. NIPTI J629034566H

ADMINISTRATORI: Z. FLORENC GJIKURIA

Subjekti ka disa vite qe ushtron aktivitetin prodhimin e betonit. Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti,argjinatura,linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Permiresimi urban i kesaj zone, e cila ka patur zhvillime mjaft te medha e te shpejta , urbanistike dinamike kohet e fundit vazhdon te terheq mjaft interesin e subjekteve private.

Aktiviteti Impiant per prodhimin e betonit është një ndërtesë me hapesiren e nevojshme per ushtrimin e ketij aktiviteti. Duhet theksuar qe subjekti ka disa vite qe e ushtron kete aktivitet ne keto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipermarresit qe kane aktivitetet prane Impiant per prodhimin e betonit.

Teritori i zgjedhur eshte mjaft i pershtatshem per funksionimin e ketij aktiviteti duke paraqitur disa perparesi si:

- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.

- Mundesi per zbatimin korekt te projektit
- Mundesi per ngritje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni I Impiant per prodhimin e betonit ka te zgjidhura disa nga problemet qe lidhen me anen funksionale si.

- Largesia te mjaftushme nga vendet e banuara.
- Prane fuqise punetore.

Aktivitetit Impiant per prodhimin e betonit ka nje kapacitet prodhues 50 m3 beton ne ore. Ne te operojne teknologjia dhe instalimet perkatese, ambientet e sherbimeve mbeshtetese dhe parkimi.

Teknologjia e Aktivitetit

Impiant per prodhimin e betonit eshte teknologji e standarteve europiane prodhim Italian.

Aktiviteti Impiant per prodhimin e betonit eshte teresisht e mbyllur dhe me kontakte teper minimale.

Procesi teknologjik I Impiantit te betonit ;

Si lende te pare perdoret Cimentoja, inertet sipas fraksioneve, aditive te ndryshem dhe uje. Impianti eshte I automatizuar dhe per perberesit e betonit shtohen materialet e mesiperme ne sasira te percaktuara per prodhimin e betonit sipas kerkesave te tregut.

Lendet e para qe ne perdorim jane kryesisht materiale qe blihen nga subjekte te licensuara . Cimento blihet e ambalazhuar.

Sasia e energjise qe ne harxhojme cdo muaj varion nga 10 000 kw cdo muaj.

Ambientet e Punes dhe ato sanitare pastrohen jo me pak se nje here ne dite dhe ne raste te vecanta me shume.

**Produkti** qe do te prodhohet ne kantier do te jete fraksione te inerteve te grupit te peste. Ky produkt do te realizohet ne impiantin e fraksionimit, materiali inert do te sigurohet nga karriera e shoqerise e pajisur me leje dhe nga me kontrate nga shoqeri te tjera. Procesi neper te cilin realizohet prodhimi i fraksioneve te lendes se pare do te

pershkruhet me poshte bashke me teknologjine perkatese.

#### IMPIANTI I PRODHIMIT TE BETONIT

Shoqeria "GJIKURIA" Sh.p.k. ka investuar ne nje teknologji bashkohore te standarteve europiane e prodhimit Italian. Ky impiant eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise, pjese teknologjike te ndryshme te saj nderohen ose modifikohen me te reja dhe shpikje te reja inxhinjerike, te cilat permiresojne eficencen dhe optimizojne perdorimin e energjise dhe ndikimin e tij ne mjedis.

**Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnje problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit.**

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Ne Impiant per prodhimin e betonit jane punesuar 8 punonjes te perhershem.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjerike është në gjendje të mirë, rrugët janë të shtruara, sipërfaqet e lira janë të gjelbëruara me pemë dekorative, sistemi i kanalizimeve, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi janë në gjendje të mirë.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin Z. FLORENC GJIKURIA janë:

- Aktiviteti Impiant per prodhimin e betonit ndodhet në një vend startegjik për zhvillimin e aktivitetit.
- Aktiviteti Impiant per prodhimin e betonit ndodhet në një zonë qe nuk dëmton Komunitetin.

- është me dalje në rrugë si dhe ekziston infrastruktura e nevojshme: rrugë, energji, ujë, sistem kanalizimesh, etj.

### **Ndikimet në mjedis**

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikoj në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonën ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-70 dB(A) gjatë punës në këtë Impiant Betoni. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ketë çlirime të aromave të ndryshme në ambientet përreth objektit e as në brendësi të tij.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës

- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitim të rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.
- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i subjektit GJIKURIA.

Ambjentet e Subjekti "GJIKURIA" Sh.p.k. pastrohen rregullisht si brenda, ashtu edhe rrethinat e jashtme dhe mbetjet urbane të akumuluar depozitohen në koshat më të afërta të plehrave të Bashkise Himare.

Aktiviteti Impiant per prodhimin e betonit pastrohet rregullisht brenda dhe jashte.

Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Ky nivel zhurmash nuk ndikon në shëndetin e punonjesve të Subjekti "GJIKURIA" Sh.p.k.dhe as në shëndetin e personave që punojnë në ambientet përreth .

Punonjësit e kësaj Impiant per prodhimin e betonit janë udhëzuar të bejnë një përdorim të duhur të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Ata janë tepër të kujdesshëm për një përdorim sa më të përshtatshëm të këtyre dy burimeve.

## **Konkluzione**

Në materialin e mësipërm shihet qarte se ka një ndikim minimal dhe pothuajse i papërfillshëm, por gjithsesi Subjekti "GJIKURIA" Sh.p.k. është e ndërgjegjshme se sado minimal ky ndikim duhet të mirë-menaxhohet dhe të bëhen përpjekje teknike për të bërë këtë ndikim me vlere zero.

Subjekti "GJIKURIA" Sh.p.k. do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për

përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresin cdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Aktiviteti Impiant për prodhimin e betonit nuk përfshihet në Shtojcën I dhe II për procedurën e VNM paraprake ose të thelluar të Ligjit Nr 10 440 për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis, datë 7.7. 2011, pra nuk i nevojitet procedura e VNM për më tepër që subjekti jone ka qenë i pajisur me Leje Mjedisore për aktivitetin. Në Perputhje me VKM nr. 419 datë 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja, ky subjekt duhet të aplikojë për leje mjedisi të tipit B në AKM-Tiranë.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tiranë, - Tel/Fax 04 2 371 237 [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)

KONFORM TË TË GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE LIGJORE NË FUQI I DREJTOHEM AKM-TIRANË PËR NDJEKEN E PROCEDURËS KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PËR APLIKIMIN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B:

ID 3.1, e. "PËRZIERJA E ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS NË MASË TË MADHE POR JO NË SHESHIN E NDËRTIMIT, PËRFSHIRË AMBALAZHIMIN DHE PËRZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE PRODHIMI I BLOQEVË TË BETONIT DHE PRODUKTEVE TË TJERA TË ÇIMENTOS (IMPIANT PËR PRODHIM BETONI)"

ADMINISTRATORI  
FLORENC GJIKURIA

TEL: 0695141396